



Mundësi punësimi në KFC Kosova

Pozita: Zyrtar/e për Kontabilitet dhe Financa

Vendi: Fshati Ndërkombëtar, Objekti Afarist, Veternik, Prishtinë

Aplikimi: Dërgoni në email jobs@kfc-ks.com, CV dhe çdo dokument tjetër relavant për pozitën në fjalë me subject **“Zyrtar për Financa”** deri më **07.09.2018**

Rreth nesh:

Brendi **KFC** është i pari kur bëhet fjalë për shërbim të pulës. Duke qenë njëri nga zinxhirët më të mëdhenj të ushqimit në botë, sot janë më shumë se 20,000 restorante në 125 vende dhe territore.

KFC në Kosovë filloi të operojë në Gusht të vitit 2016. Kurse, tani vetëm se jemi duke u zgjeruar në Maqedoni me dy lokacione të reja - në Shkup dhe Tetovë.

Plani strategjik, vizionar dhe ekipi janë duke bërë të mundur që në të ardhmen të zgjerohemi edhe më tej me shumë restorante, lokacione e pika të reja, me një staf edhe më të madh duke krijuar të ardhme të ndritshme për të gjithë ata që vendosin të i bashkohen familjes së **KFC**.

KFC Kosova është një vend i mrekullueshëm për të punuar, me një ambient pune argëtues dhe motivues, me mundësi zhvillimi dhe avancim për gjithë ata që duan të kenë një karrierë të bujshme. Sot, kemi punësuar mbi 150 individë, me karrierë të ndritshme në 9 restorantet tona nëpër Kosovë dhe më shumë se 15 në zyrën tonë qendrore, të cilët dinë si të jenë më të mirët, dinë të krijojnë ndryshimin, si dhe më e rëndësishmja dinë si të bëjnë qejf.

Ne jemi energjik dhe të pasionuar për atë që bëjmë. Përderisa, vazhdojmë të zgjerohemi në të gjithë vendin, ne jemi gjithmonë në kërkim të kandidatëve të kualifikuar, të cilët kanë vizion dhe vlera njerëzore.



“KAN” sh.p.k

Fshati Ndërkombëtar, Objekti Afarist, Veternik

+381(38)602122 - info@kfc-ks.com

Nr. Fiskal: 601292808 Nr. Biznesit: 71186121

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Koordinon dhe është përgjegjës për regjistrimin e të gjithë dokumentacionit financiar;
- Bën regjistrimin kontabël të të hyrave dhe shpenzimeve, dhe urdhëresave tjera në softuerin e kontabilitetit;
- Bën përcjelljen dhe barazimin e llogarive të arkëtueshme dhe pagueshme dhe përpilon raportet përcjellëse në baza të ndryshme periodike sipas kërkesës;
- Mirëmban regjistrin e aseteve fikse, llogarit zhvlerësimin e aseteve dhe bën dorëzimin e regjistraven kontabël tek mbikëqyrësi;
- Bën barazimin e llogarive të stoqeve me kontabilitetin financiar;
- Mban dhe është përgjegjës për sistemin e kontabilitetit sipas legjislacionit tatimor dhe parimeve të kontabilitetit;
- Përgatit deklarin e TVSH-së, tatimeve edhe detyrimeve të tjera ligjore brenda afateve të përcaktuara me ligj;
- Kalkulimi i pagave dhe raportimi i tyre në Administratën Tatimore;
- Bën arkivimin dhe sistemimin e dokumenteve financiare;
- Monitoron llogaritë bankare dhe përgatit raporte periodike sipas kërkesës;
- Bashkëpunim dhe koordinim me bashkëpunëtorët e jashtëm, nëse ka të tillë.

Kualifikimet dhe aftësitë e kërkuara:

- Të ketë të përfunduar studimet Bachelor – Fakulteti Ekonomik, drejtimi Financa dhe Kontabilitet;
- Të ketë përvojë pune minimum 2 vjet në kontabilitet - Përvoja paraprake e kontabilitetit në lëminë e prodhimit dhe restoranteve, do të jetë përparësi në përzgjedhje të aplikuesve;
- Te posedoj Çertifikime profesionale të kontabilitetit nga institucione të akredituara perkatese;
- Të ketë njohuri shumë të mira në përdorim të Excel-it – Excel i avancuar;
- Të ketë aftësi të mira komunikuese si në të folur ashtu edhe në të shkruar në gjuhën shqipe dhe angleze;
- Të jetë i gatshëm të punojë në ekip dhe të menaxhojë me situatat sfiduese.